



HZ. HYSEJNI,
DJALI I ALIUT (R.A)



RENDJA E ZEMRAVE



KUJDESI I MUHAMMEDIT (A.S)
NDAJ TË MOSHUARVE
DHE TË VARFËRVE

Viti XIV - Nr. 1 (155),
Janar, 2016

Botim i Myftinisë Shkodër

UDHA ISLAME

E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

“PËR NDRYSHE... MYSLIMANIZMI, SHQIPNISË KÁ ME I THANË LAM T’U-MIRË!”

*"Na Shqiptarët
në Shqipëni si mundim
me e mbajt fenë?
Mundim me e mbajtë fenë
në qofshim se bij e bijavet
t'ona do t'u mësojmë
H. Kuranin bashkë
me thelbin e tij.
Për ndryshe si thamë
mâ sipër myslimanizmi,
Shqipnisë ká me i thanë
lam t'u-mirë.
Të nderçmit ulema
e Meshajih. Nuk âshtë
koha me fjet, duhet
të vemë gishtin e të
mentohemi, se po ikim."*





Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

Të gjitha falënderimet e plota dhe madhështia absolute i takojnë Zotit të vetëm të gjithësisë, të Plotfuqishmit All-llah, i Cili urdhëron në Kur'anin Famëlartë: "Dhe (mua më shpallet) se vërtetë xhamitë janë caktuar për ta adhuruar All-llahun, e mos adhuronit në to askë tjetër me All-llahun!"¹

Salavatet dhe selamet më të përzemërta ia dërgojmë sot në këtë ditë dhe në çdo ditë të jetës tonë, zotërisë së bijve të Ademit, Hz. Muhammedit (a.s), i cili na lajmëron se All-llahu i Madhëruar ka thënë: "Shtëpitë e Mia në tokën Time janë xhamitë! Vizitorët e tyre janë gjallëruesit e tyre. Bekuar qoftë ai njeri që pastrohet në shtëpinë e tij, pastaj më viziton në shtëpinë Time! Të vizituarit i takon ta nderojë vizitorin e tij!"²

TË DASHUR DHE TË NDERUAR VËLLEZËR BESIMTARË,

Tema e kësaj hytbeje, që kam vlerësuar të jetë edhe mesazhi i javës, lidhet me xhamitë dhe ndjeshmëritë tona ndaj tyre. Nëpërmjet këtij mesazhi, dua të ftoj të pranishmit dhe lexuesit, që të jenë të vëmendshëm dhe të kujdesshëm ndaj xhamisë dhe rolit të saj në shoqëri, si djep edukimi, si vend adhurimi, si stacion qetësie dhe lutjesh drejtuar Zotit të Vetëm të botëve, si qoshk reflektimi dhe pendimi drejt më të mirës në jetë, si mësonjëtorja e parë drejt rrugëtimit të dijes, urtësisë dhe përkushtimit ndaj Zotit!

Dhe, shkak i këtij mesazhi u bënë dy

1. Kur'ani, El-Xhinn: 18.
2. Hadithi i dobët, sipas analizës së Zejaliut dhe Irakiut, por që forcohet me transmetime të shumta të ngjashme, të transmetuara nga Tabaraniu, nga Selmani (r.a) dhe të saktësuara nga dijetarë të ndryshëm të hadithit.

"PËR NDRYSHE... MYSLIMANIZMI, SHQIPNISË KÁ ME I THANË LAM T'U-MIRË!"

lexime të largëta në kohë, të afërta në thelbin e temës, të shkruara në revistën "Zani i Naltë" në vitet 1924 dhe 1925.

Fillimisht, në vitin 1925, një autor shkodran, në një shkrim shumë interesant me titull: "Pse larg xhamisë?"³, i drejtohet "masës së ré shqyptare myslimane"⁴, ku ndër të tjera thekson, se: "... kur Shqyptari hyni në marrëdhënie me pjesëtarë të kombevet tjerë, filloj me ndi një ftohtësi ndaj detyrimeve të fesë; ftohtësi që më tepër u çfaq në djelmënin t'onë. Tuej e sjellë nevoja që djali mysliman të jetë në kontakt me të hujët, vrrajti një diferencë të madhe në mes të vedit e të huejit për kahë veshja e mbatha e për kahë sjelljet tjera. Kishte mângut koletin e gravatin: i vueni këta, tuej plotsue një ndër të mbeta që shihte më vedit..."⁵

I ngrati njeri, a thua se veshja dhe rroba, forma trupore dhe paraqitja fizike e bëjnë njeri, bashkëkohor e të qytetëruar!? Ndërkohë, Hz. Muhammedi (a.s) na mëson se: "All-llahu nuk i shikon format dhe pasuritë tuaja, por vështron në zemrat dhe veprat tuaja"⁶ (Normalisht, hadithi në fjalë nuk përjashton as largon vëmendjen nga përkujdesja e muslimanit ndaj pastërtisë dhe shijes në veshje e prezantime, por tërheq vëmendjen ndaj shkallës së përparësive në marrëdhënie me Zotin, veten dhe ambientin).

Por, thelbi i shkrimit nuk ka dalë akoma në skenën e leximit tonë. Autori vijon: "Nji ditë prej ditësh takoj rasti që ndonji dijetarit (alim) na i rá në sý kjo veshë; e kur djaloci i ynë hyni si pá-hiri në xhami, ndeshi para një volkani që në vënd të llavës shpërthente njimij të shame: ndeshi në dijetarin (alim). Djali trembet, desherohet edhe bân bé që sikur edhe fesi t'i binte në xhami nuk do të hynte më marrë!..."⁷

3. Shkrimi: "Pse larg xhamisë?", në revistën "Zani i Naltë", nr. 9, Tiranë, nantuer 1925, viti i II-të, f. 668-672.

4. Po aty, f. 668.

5. Po aty, f. 668.

6. Transmetuar nga Bukhariu dhe Muslimi, nga Ebu Hurejra (r.a).

7. Shkrimi: "Pse larg xhamisë?", cit. më lart, f. 668.

*Dua të ftoj të pranishmit
dhe lexuesit, që të jenë
të vëmendshëm dhe të
kujdesshëm ndaj xhamisë
dhe rolit të saj në shoqëri,
si djep edukimi, si vend
adhurimi, si stacion qetësie
dhe lutjesh drejtuar Zotit
të Vetëm të botëve, si qoshk
reflektimi dhe pendimi drejt
më të mirës në jetë,
si mësonjëtorja e parë drejt
rrugëtimit të dijes, urtësisë
dhe përkushtimit ndaj Zotit!*

Nuk janë të pakta rastet, kur në xhamitë tona ka munguar pjekuria e trajtimit të rinisë dhe fëmijëve të vegjël, që e kemi për detyrë të përkujdesmi për ta, më shumë se për këdo tjetër, sidomos kur është në diskutim edukimi fetar dhe formimi i boshtit të fesë në ndërgjegjen e tyre!

E vërteta është se pas shkëputjes së viseve tona shqiptare nga kalifati i lavdishëm osman, armiqtë e Islamit dhe muslimanëve nuk pushuan së punuari me të gjitha format dhe mënyrat e tyre për ta zbehur besimin dhe formimin islam të shqiptarëve. Sot, janë dëndur metodat dhe janë shtuar duart që bashkëpunojnë me krejt forcat e tyre në këtë drejtim!

Në vitin 1940, nëpërmjet revistës tonë "Kultura Islame", Kryetari i Komunitetit Mysliman, Dr. Behxhet Shapati, shkruante dhe deklaronte botërisht, se: "Sikur dihet prej të gjithëve populli mysliman mbas sundimit Otoman, si në vetësundimin e vet ashtu edhe n'okupacionet e huja, deri 10 a 15 vjet përpara nuk ka pas asnjë pengim a vështirësi për me u organizue e me ushtrë besimin e vet n'atë formë që ja

porositte besimi i vërtetë i tij.

Nuk e mohojmë që ndonji rast disa njerëz për interesa personale, tuej ba vegël fenë, të kenë luftë edhe disa role politike... E keqja nuk maronte me kaq, por edhe mbassi qe stabilizue deri diku Shteti Shqiptar me vujtje e sakrificë të mdha, filluen kësaj here njerzit e Qeverisë me ja mohue këtë populli indirekt edhe ushtrimet e traditat fetare si abrogim i të drejtave fetare, ndalimi i shenjit tradicional të Ramazanit, propagantë antifetare si dhe ndalim' i festimit tradicional të Lindjes së Profitit t'onë ndër disa vise e sa e sa tjera që i dijmë të gjithë.

Veç kësaj, pasunitë vakfnore që u lan trashigim prej të parvet mysliman vetëm për qëllime bamirsije dhe për përmbajtje të fetarvet dhe t'instituteve t'elementit Mysliman, u damtuen me mënyra të ndryshme sa që u vuen në një gjendje aq të mjerushme për mos me mujtë me i përgjigjë mâ n'asnjë mënyrë qëllimeve, për të cilët ishin destinue..."⁸

Kjo kazëm e pabesë dhe tinzare, vetëm se ka ardhur duke u thelluar në dëm të Islamit dhe muslimanëve shqiptarë në vendin tonë, sidomos në emër të laicizmit selektiv, ku komunitetet fetare përherë e më shumë po trajtohen të pabarabarta, në dëmin e Islamit dhe muslimanëve!

TË DASHURIT E MI,

Ne si muslimanë, duhet të ndjehemi krenarë dhe me dinjitet të lartë ta mbrojmë interesin e fesë tonë, sepse ne "Besojmë në një Dinë, për të cilin duhet të jemi madhështorë. Duhet të jemi kryenaltë kur kryejmë detyrë qi ky Dinë na i imponon⁹. Jemi – falë i kjosim Zotit – antarët e njatij Dini qi e bân me thanë një ndër pjestarët e akademis franceze: "Islamët – besimtarët e Dinit të Muhammedit – janë mësuesat t'onë në lâmen kulture, gjâ qi s'duhet t'a mohojmë." E ti, masë e ré (rini) ké guximin me vuem gojë mbi këtë Dinë e me përbuzë xhaminë?! Turp besa!"¹⁰

8. Dr. B. Shapati, "Gjendja e djeshme dhe e sotshme e elementit shqiptar mysliman në Shqipëri", në revistën: "Kultura Islame", Viti I, Tiranë, Fruer-Mars, 1940, nr. 6-7, f. 203-204.

9. Natyrshëm, kjo fjalë duhet kuptuar drejtë me qëllimin e udhëzimit hyjnor dhe obligimeve të ndryshme fetare në Islam, jo ndryshe! (Shënim imi. M.S.)

10. Shkrimi: "Pse larg xhamisë?", cit. më lart, f. 671.

**"BESOJMË NË NJI DINË,
PËR TË CILIN DUHET
TË JEMI MADHËSHTORË.
DUHET TË JEMI KRYENALTË
KUR KRYEJMË DETYRËT
QI KY DINË NA I IMPONON.
JEMI – FALË I KJOSHIM ZOTIT –
ANTARËT E NJATIJ DINI QI E BÂNI
ME THANË NJI NDËR PJESTARËT
E AKADEMIS FRANÇEZE:
"ISLAMËT – BESIMTARËT
E DINIT TË MUHAMMEDIT – JANË
MËSUESAT T'ONË
NË LÂMEN KULTURALE,
GJÂ QI S'DUHET T'A MOHOJMË."**

Në fakt, turpi më i madh duhet të na rëndojë neve, imamëve, myftilerëve, kujdestarëve të xhamive, por jo vetëm, që nuk jemi angazhuar akoma si duhet me rininë tonë, për ta ftuar drejt xhamisë, për t'ia hapur dyert e dialogut dhe komunikimit, për të dëgjuar prej tyre, për t'ia mësuar fenë, për t'u ulur dhe për t'u kuptuar, për të toleruar e për të duruar në rrugën e gjatë të udhëzimit dhe drejtimit të përbashkët drejt Zotit dhe fesë së Tij!

Realitetet e sotme po dëshmojnë përherë e më shumë tentativa nga më të ndryshmet që tentojnë ta marrin për dore rininë tonë muslimane drejt humnerave morale dhe tjetërsimit të identitetit!

A nuk jemi dëshmitarë të organizimeve plot shthurje dhe alkool, gjatë krejt muajit dhjetor që kaloi, aty para dritareve të xhamisë "Ebu Bekër"?

A nuk jemi dëshmitarë të organizimeve të shthurra plot muzikë të djallëzuar, para Bashkisë Shkodër, në netët e fundit të Ramazanit që kaloi? Sepse institucionet tona janë të sëmura, janë infektuar dhe për pasojë përhapin infeksion në emër të dëfrimit dhe alternativës, festimit dhe argëtimit kolektiv!

Ndërsa ne, kemi ngelur të mbyllur brenda katër mureve të xhamive tona, pa forcë organizimi, pa ndjenjë mase, pa kurajon për t'u ngritur dhe për të ndaluar atë që nuk duhet të jetë në lagjet tona, në rrugicat tona, pranë xhamive tona, pranë institucioneve tona! Pa forcën e kurajos për të mos shkuar si kope delesh pas njerëzve

me identitet laraman dhe ndërgjegje të sëmure!

PËR FUND TË KËSAJ HYTBEJE DHE MESAZHIT TË SAJ,

Dëshiroj ta mbyll me një mesazh plot urtësi dhe largpamësi, me të cilin, dijetari i madh i kombit tonë, Hafiz Ali Korça i drejtohet ulemave të vendit tonë, në vitin 1924, ku ndër të tjera thekson: "Sikushi e din bukur se feja mbahet e ruhet vetëm me dituni. Në këtë botë pa dituní as gjâ s'mundet me u rujt.

Si kena shkrum edhe të tjera herë, ndër ata shekuj qi ka mbretënum ditunija plotësisht edhe myslimanizmi ka çkëlqym me të tepër.

Ndër ato mbrëtni myslimane q'asht fikun drita e ditunisë, e dhe feja pa dyshim ka ngel në mjegull edhe s'ka mund me e qit atë rrezen çkëlqimore si e ka dasht nevoja.

...

Për njerinë m'i math armik se çditunija s'ka.

Pa dituni s'mundet të mbahet as fe as shtet as shtëpija e vetë.

Zoti, ditunin e quan ngjallje dhe çdituninë vdekje. Ahere prej të vdekve ç'presim?

Kjo fe kurdoherë është mbajt me anën e medreseve dhe prapë me anën e tyne mundet me u mbajt. Për ndryshe në Shqipni kam frikë se do t'a ketë jetën të shkurtë.

...

Na Shqiptarët në Shqipëni si mundim me e mbajt fenë? Mundim me e mbajtë fenë në qofshim se bij e bijavet t'ona do t'u mësojmë H. Kuranin bashkë me thelbin e tij. Për ndryshe si thamë mâ sipër myslimanizmi, Shqipnisë ká me i thanë lam t'u-mirë.

Të nderçmit ulema e Meshajih. Nuk është koha me fjet, duhet të vemë gishtin e të mentohemi, se po ikim.

A nuk po shifni se çunat qi na arrinë moshën (20) nuk po dinë me prumun shehadet; pale ata fëmijë qi po këndojnë në rahlet të rahibëve dhe rahibeve se ç'kanë me u bâ! ..."¹¹

(Hythe e mbajtur në xhaminë e Dudasit)

Shkodër, më 15 janar 2016

11. H. ALI, "Letr' e hapët për gjith ulemat e meshajihat qi ndodhen në Shqipni", në revistën "Zani i Naltë", nr. 8, Tiranë, maj 1924, viti i I- rë, f. 238-246.



Sheikh Vehbi S. Gavoçi

JETËSHKRIMI E TRAGJEDIA

H. Hysejini, djali i Aliut (r.a) kishte nënë Fatimen, vajzën më të dashur të Profetit (a.s). Lindi në muajin Shaban, në vitin e 4-ët, një vit mbas vëllait të vet, h. Hasanit. Të dyve emrat ia përzgjodhi vetë Profeti (a.s).

Që në vegjëli, ai dhe i vëllai u rritën nën kujdesin dhe edukimin e Profetit (a.s). Kur Profeti (a.s) vdiq, Hysejini ishte 6 vjeç, ndërsa vëllai i tij Hasani ishte 7 vjeç.

Kur i ati i tyre u vra, h. Hasani dha dorëheqjen nga Kalifati, u kthyen në Medinë, ku jetuan me lutje, bamirësi e sjellje të lavdërueshme.

Kur vdiq h. Hasani (r.a), h. Hyseni mbeti vetëm. Në vitin e 60-të të hixhretit, Muavija emëroi djalin e vet Jezidin, zëvendës dhe dërgoi në Medinë një njeri të vetin për të marrë besën e pëlqimin e h. Hysejinit e të tjerë njerëzve të mëdhenj, që të jetë Jezidi kalif, ose mbret mbas babës së vet.

Disa njerëz u fshehën, disa të tjerë ikën në Meke, prej tyre qe edhe h. Hysejini.

Në atë vit që ishte në Mekë, e kishte vdekur Muavija, vendin e kalifit ia zuri djali i tij, Jezidi.

Njerëzit, të mërziur nga sjelljet e liga të Jezidit, i dërgonin letra e delegatë h. Hysenit, që të shkonte në Kufe (në Irakun e sotëm), të bëhej kalif dhe i jepnin besën se do të ishin me të.

H. Hysejini pyeti këshilltarët e njerëzit e mençur, por askush nuk pëlqeu që ai të shkonte atje, duke i thënë se ata, të cilët të thërrasin sot, kanë qenë tradhtarë të babës tënd dje.

Kështu i tha djali i xhaxhait, Abdullahu, djali i Abazit, ashtu qe mendimi i Abdullahut, djalit të Ymerit, kurse vëllai i tij nga baba, Muhamedi, qau shumë, kur pa se Hysejini donte të shkonte në Kufe. Të gjitha këto mendime nuk u morën parasysh nga h. Hysejini.

H. Hysejini, dy ditë para haxhit,

HZ. HYSEJNI, DJALI I ALIUT (R.A)

doli nga Meka për të shkuar në Kufe së bashku me familjen, me njerëz të fisit e të tjerë dashamirës. Më parë kishte dërguar në Kufe djalin e xhaxhait të vet, Muslimin, djalin e Akilit. Ky u prit mirë. Posa mbërrini, mori besën nga njerëz se ata do të ishin me h. Hysejnin, por ata shpejt u larguan e humbën si shkumë sapuni, sa e hodhën prej një ndërtese të lartë Muslimin, i cili vdiq në rrugë të madhe. Kështu ata që deshën të jenë me h. Hysejnin, u frikësuan më tepër.

Gjatë rrugës, në Kadisiye, h. Hysejnit i erdhi lajmi i mbytjes së Muslimit. Vëllezërit e Muslimit thanë se ata do të vazhdojnë rrugën, nuk ktheheshin, ose të fitonin luftën, ose të binin dëshmorë. H. Hysejini u tha atyre: “Jeta pa ju nuk është e ëmbël”.

H. Hysejini mbledhi njerëzit që kishin dalë nga Meka, iu kallëzoi çka ndodhi e se ishin në rrezik për t’u vrarë, nëse vazhdonin rrugën me të për në Kufe. Disa njerëz vendosën të kthehen nga kishin ardhur. Me h. Hysejnin nuk mbeten, veç disa anëtarë të fisit dhe familja me gra e fëmijë që arrinin në 73 vetë, prej të cilëve 32 ishin luftëtarë kalorës.

Abdullahu, djali i Zijadit, ishte përgjegjësi për Irakun e Kufen nga ana e Jezidit.

Ky dërgoi kryetarin e policisë deri në Kadisiye, ku qëndronte h. Hysejini me njerëzit e vet dhe përhapu ushtrinë e vet prej 1000 kalorësish në atë fushë të madhe, gjoja për të rrethuar h. Hysejnin, që mos ta linte të largohej nga vendi ku ishte me atë grup të vogël me gra e fëmijë.

Kjo gjë ndodhi në drekë, në kohë të vapës së madhe. H. Hysejini me shokë u përgatit për të falur drekën. Para se të falej u shpreh kështu. “I kërkoj falje Zotit (xh.sh) dhe ju”.

Mandë iu drejtua ushtrisë: “Unë nuk erdha te ju, ju më thirrët me letra e delegatë, më thonit nuk kemi drejtues, prandaj erdha, pra, nëse më jepni fjalën që më qetëson zemrën se vërtetë më doni, po vij, përndryshe unë po kthehem nga kam ardhur”. Heshtën të gjithë e askush nuk foli as mirë, as keq. U fal h. Hysejini me njerëzit e vet dhe ushtria me komandantin e saj Hur’rin¹. Mbasi h. Hysejini fali iqindinë, foli përsëri: “Ju doni Zotin (xh.sh) dhe e dini të drejtën që i takon njeriut. Ajo gjë është çka pëlqen Zoti (xh.sh) prej jush dhe e dini se ne, Fisi

1. Ai është El-Hur’r ibn Jezid Et-Temimij

i Profetit (a.s), jemi më të aftë për kalif se Jezidi. Nëse nuk njihni të drejtën tonë, unë po kthehem nga erdha”. Dhe, derdhi dy hejbe të mbushura me letra e kërkesa për ardhjen e tij në Kufe.

Mandë foli Hur’ri, i pari i ushtrisë, që tha: Ne jemi të urdhëruar që të mos ju lëmë të shkoni nga të doni, por në anë të Abdullahit, djalit të Jezidit.

Këtu h. Hysejini mësoi lojën e fëlliqur e dinakërinë e atij që dëshironte ta poshtëronte, prandaj iu përgjigj: “Më lini të kthehem nga kam ardhur, ose më lejoni të luftoj kundër armiqve të fesë, ose më lini të shkoj në Damask te Jezidi!”

*QË NË VEGJËLI,
AI DHE I VËLLAI
U RRITE NËN KUJDESHIN
DHE EDUKIMIN
E PROFETIT (A.S).
KUR PROFETI (A.S) VDIQ,
HYSEJNI ISHTE 6 VJEÇ,
NDËRSA
VËLLAI I TIJ HASANI
ISHTE 7 VJEÇ.*

Komandanti i refuzoi të gjitha propozimet dhe egërsisht tha: Nuk ka rrugë tjetër, përveç për në Kufe me rojën tonë.

H. Hysejini doemos nuk pranoi fjalën e atij komandanti që ulte familjen e Profetit (a.s) dhe vëllain e kalifit për ta dorëzuar veten ashtu, në mënyrë fyese. Ai vendosi të luftojë, të mos dorëzohej, duke besuar se ai lufton për të drejtën e se armiku është i gabuar.

H. Hysejini iu drejtua pasuesve të tij me këto fjalë: “Shokët tanë të Irakut (Kufe) hoqën dorë nga ne e na lanë në baltë. Kushdo prej jush le të kthehet, ne nuk ndëshkojmë, ose deklarojmë që ka humbur besën”.

Në këtë çast u larguan edhe një sasi tjetër njerëzish që kishin ardhur me të nga Meka e shkuan në anën e ushtrisë.

Kështu hz. Hysejini mbeti gati krejt vetëm me familjen e vet.

Ai, me ata që mbetën me të, pak burra, më tepër gra e fëmijë, u përpoq të shkonte diku, mirëpo komandanti Hur'ri i doli përpara dhe i tha: Jam i urdhëruar për të të marrë e për të të dërguar te Zijadi në Kufe, për të mos lënë të kthehesh nga ke ardhur, ose të shkosh në ndonjë vend tjetër. Në daç eja me mua, mos hyr në Kufe dhe unë po kërkoj prej Zijadit për t'ju falur dhe ai t'u dërgojë te Jezdi. Inshallah kalon ky problem me paqe, pa derdhur gjak e ruana nga ai mëkat i madh.

Të xhumanë, me 3 Muharrem 61, erdhi Omeri, djali i Zijadit, me një fuqi ptej 4000 kalorësish. Shumë prej tyre ishin nga ata që i kishin shkruar hz. Hysenit për të ardhur në Kufe, për ta vënë kalif.

Komandanti i ri, i dërgoi delegat hz. Hysejinit duke i thënë: Çka të ka sjellë këtu? Hs. Hysejini u përgjigj: "Më kanë shkruar shumë njerëz prej këtu për të ardhur, pra nëse nuk më doni sot, unë po kthehem nga kam ardhur".

Komandanti i Zijadit i ktheu këtë përgjigje: Duhet t'i japësh besën Jezidit si kalif, nëse nuk pranon, do t'u ndalohej uji i pijshëm njerëzve që janë me ty.

Kjo gjë ndodhi me 6 Muharrem.

Për ca kohë shkuan e erdhën delegatë ndërmjet hz. Hysejinit e komandantit Omer. Në fund Omeri i dërgoi Zijadit këtë lajm: Lavdi i qoftë Zotit (xh.sh), i cili bashkoi fjalën e besimtarëve me hz. Hasanin e u ndal lufta ndërmjet besimtarëve. Hs. Hysejini më ka thënë se ai kthehet në vend nga ka ardhur, nëse doni shkon për një luftë kundër armikut, ose shkon te Jezidi, ku vendos dorën e vet në dorën e tij. Kjo gjë është më mirë për kombin e popullin tonë.

Zijadi i mjerë, në vend që të pranojë një nga të tre propozimet, dërgoi një oficer të egër i quajtur Shumer me një letër me këtë përmbajtje: "Thuaji Hysejinit le të zbatojë kërkesën time, nëse nuk pranon, atëherë do të luftohet."

Zijadi i tha gjithashtu këtij oficeri, nëse pranon urdhrat e mia mirë, përndryshe, vrite atë e ti do të jesh komandanti!

Mbërriti letra e Zijadit me atë oficer. Omeri urdhëroi ushtrinë që të përgatitet për të luftuar. Mijëra ushtarë kundra 54 burrave, më pak gra e shumë fëmijë.

Hs. Hysejini e kuptoi gjendjen, prandaj kërkoi prej Omerit që të priste deri të nesërmen në mëngjes. Natën e fundit hz. Hysejini me shokë u falën e u lutën, kërkuan ndihmë prej Zotit (xh.sh).

Të xhumanë, ose të shtunën, me 10 Muharrem, ushtria e madhe sulmoi kundra 30 burrave këmbësorë. Ranë njerëzit e

mirë, njeri pas tjetrit e u rrethua hz. Hysejini, i cili luftoi me burrëri e zemër të fortë, si babai i vet. Kështu erdhi dreka, ndaluan luftën e u falën. Lufta filloi përsëri, të thuash kundra një burri, u plagos rëndë hz. Hysejini, derisa u rrëzua për tokë.

Në këtë çast, një ushtar dorëthyer i ra me shpatë dorës së majtë. Atë gjak që ra, hz. Hysejini e priti me dorën tjetër, e derdhi në tokë e tha: "Hej Zot, nëse nuk do të më ndihmosh, le të jetë kjo për të mirën tonë, të na pranosh dëshmorë edhe merre të drejtën tonë te këta njerëz brutalë!"

Hs. Hysejinit iu shtua etja, si i shtohet të plagosurit, mori për t'iu afruar ujit për të pirë pak. Këtu i ra një dorëthyer me një shkop me majë hekuri në gojë, i doli gjak nga goja, e priti atë në duart e veta e tha: "Hej Zot, këtyre që më ndaluan të pi ujë, merrua shpirtrat etshëm!"

Hs. Hysejini iu lut Zotit (xh.sh), duke thënë: "Ti sheh çka po bëjnë me nipin e Profetit tënd, hej Zot, ndiqi ata të gjithë, mbyti ata të gjithë, mos lër asnjë prej tyre!"

Ashtu ndenjor siç ishte, hz. Hysejini (r.a) nuk pati fuqi për të luftuar, mirëpo ushtarët u frikësuan për t'iu afruar, se e dinin mirë se çfarë krimi të rëndë po bënin, por i mjeri Shumer, bërtiti duke u thënë: Çka prisni?

Atëherë ushtarët i ranë me shpatë, deri sa e mbytën atë njeri të pastër.


Hs. Hysejini, nipi i Profetit (a.s) u mbyt në mënyrë të poshtër nga disa njerëz që quheshin muslimanë, u mbytën edhe ata që ishin me atë, rreth 88 vetë, përveç të plagosurve.

Hs. Hysejini u vra në fushë të Kadisijes që u quajt qysh herët Qerbela, të xhumanë, me 10 Muharrem të vitit 61-të emigrimit.

Kështu iu ul perdja një krimi të rrallë në historinë Islame, mbaroi tragjedia aq e dhimbshme në zemrat tona.

* * *

Shpresojmë se paraqitja e jetës dhe e veprimtarisë së sahabëve dhe të kalifëve të parë të përmendur do të ndihmojnë besimtarët për të njohur më mirë, më thellë e më drejt këtë pjesë të historisë islame dhe gjithashtu do të ndikojë për një formim më të mirë fetar Islam.



**"MYSLIMANI
NUK ËSHTË KRIJUAR
QË TË SHKOJË
SIPAS RRYMËS
DHE TË ECË
NGA TË FRYJË ERA,
POR AI ËSHTË KRIJUAR
QË TË UDHËZOJË
BOTËN".**

Muhammed R. Bal

(1877 – 1938)



Sheikh Muhamed El-Gazali

Ndjeva ngushtim në zemër dhe shpërqendrim mendimesh! Kuptova se gjykimi im mbi gjërat do të më largohet nga e drejta nëse do të vazhdoj të jem nën ndikimin e kësaj gjendje, kështu që thashë: Të kërkoj falje, o Zot dhe pendohem tek Ti, ndoshta më çlirohet kraharori dhe ekuilibri më rregullohet!

Por, një zë i mekur në shpirt më thotë: Përse të kërkoj falje? Ti nuk ke gabuar në diçka dhe as i ke bërë ndokujt zullum, prandaj rri i qetë...

Me vete thashë: A duhet të pres derisa të sillem keq, apo të kaloj caqet, pastaj të kërkoj falje?

Gjendja prej të cilës vuan, ajo është ena, në të cilën lindin të këqijat, pastaj rriten, derisa sapo të vijë rasti për t'u shfaqur, ato lëvizin. Dhe, zemra e ngurtë, ajo është e cila të shtyn, herë drejt të mëdhave, herë drejt ankesave dhe herë drejt padrejtësive ndaj të tjerëve. Nëse ndjen se zemra jote ka filluar të ngurtësohet, paraprij rrezikut dhe përkujtoje fjalën e Allahut: "Mjerë për njerëzit, që zemrat e tyre janë të ngurta prej përmendjes

RENDJA E ZEMRAVE

"MJERË PËR NJERËZIT, QË ZEMRAT E TYRE JANË TË NGURTA PREJ PËRMENDJES SË ALLAHUT..." (EZ-ZUMER: 22)

së Allahut..."¹.

Allahu e begaton ndonjë prej krijesave të Tij dhe ai i mjeri thotë: Këto janë frytet e gjenialitetit tim, rezultat i mundit dhe vendosmëria ime, e mbushet me mburrje e krenari: "E nëse njeriu e godet ndonjë e keqe, na lutet Neve, pastaj nëse ia shndërrojmë në një të mirë prej Nesh, thotë: Kjo më është dhënë prej diturisë, ndërkohë që ajo është sprovë (fitne), por shumica e tyre nuk e dinë. Atë e kanë thënë edhe të tjerët përpara tyre, e asgjë nuk u bëri dobi prej asaj që kanë punuar"², prandaj le t'i shikojë njeriu punët e tij të brendshme, sepse fesadi i jashtëm, (pjesa më e madhe e tij), vjen prej prishjes së brendshme...

Transmetohet se një njeriu të ditur, i erdhi një kriminel, që e kishte bërë zakon të vriste dhe e pyeti: A ka pendim për mua? I dituri iu përgjigj: Kush të pengon prej pendimit? Lëshoje tokën tënde, në të cilën jeton dhe shko te një tokë e mirë, të të ndihmojë që të drejtohesh! Njeriu u drejtua për te fshati, i cili do ta ndihmonte drejt përkushtimit ndaj Allahut.

Por, vdekja e tij e zuri në rrugë! Thuhet se, kur e ndjeu se po i afrohet exheli, filloi të bëjë me gjoks përpara, por... . Pejgamberi (a.s) tha: "Për të debatuar melekët e mëshirës dhe

melekët e dënimit. Melekët e mëshirës thanë: Ai ka ardhur i penduar, me zemër të drejtuar nga Allahu (xh.sh). Melekët e dënimit thanë: Ai nuk ka punuar kurrë asnjë të mirë! Ndërkohë vjen një melek tjetër në formën e një njeriu dhe, e bënë gjykatës në mes tyre. Tha: Matni distancën mes dy tokave dhe në cilën prej tyre ka qenë më afër, asaj i përket. E matën dhe e gjetën më afër tokës, për të cilën ishte nisur, me një pëllëmbë, e kështu e morën melekët e mëshirës..!

Një pëllëmbë e vetme përcaktoi përfundimin e tij! Nuk ishte këmbë që lëvizte, por ishte përpjekje zemre e një të penduari, i cili vdiq rrugës duke u kthyer për tek Allahu. E bëri të zotën e saj (e ai po kacafytej me vdekjen) të lëvizte përpara.

Besimtari gjithmonë shikon drejt përsosjes, shqetësohet përherë nga të metat dhe nuk prehet në një situatë, nëse mbështetet tek ajo, mund të bie në fund. Ndoshta për këtë Pejgamberi (a.s) ka thënë: "O ju njerëz, pendohuni tek Allahu, sepse unë pendohem tek Allahu, çdo ditë e natë, njëqind herë".

Kjo është një ftesë aktive për lartësim, për sa kohë jeta ekziston.

Përktheu nga arabishtja:

Lavdrim Hamja

الْبَذْرِ لِلَّهِ نَظْمَيْنِ الْفُلُوبِ

1. Kur'ani, Ez-Zumer: 22.

2. Kur'ani, Ez-Zumer: 49-50.



Hfz. Mehas Alija

Imam, B.I. "El-Hidaje", St. Gallen, Zvicër

I Dashuri ynë, Muhammedi (a.s), diti t'i vlerësojë dhe t'i çmojë shumë lart gjyshet dhe gjyshërit, nënat dhe baballarët, duke u dhënë të drejtën e respektit dhe nderimit. Ai, shumë shpesh thoshte: "Nuk është prej nesh ai i cili nuk i respekton pleqtë." (Pra, nuk është si Muhammedi (a.s), në besim (iman), në jetën e tij përkushtuar Allahut, respektivisht në jetën e tij me përvojë të pasur, të cilën nuk do të duhej aspak ta shpërfillnim.)

Në një rast, gjersa Muhammedi (a.s), përgatitej për një betejë, i vjen një burrë dhe i kërkon leje që të marrë pjesë edhe ai në luftë. I Dërguari (a.s) e pyeti: "A ke ndonjë prej prindërve gjallë? Po, i tha i djaloshi, të dy janë gjallë. Atëherë kthehu tek prindërit e tu, dhe bëju atyre mire." - i tha!

Gjithashtu, transmetohet se një ditë, teksa muslimanët përgatiteshin të bënë hixhret, Pejgamberit (a.s) i erdhi një djalë i ri dhe i tha: "O i Dërguari i Allahut, dua të bëj edhe unë hixhret, ndonëse prindërit i kam lënë duke qarë për mua. Muhammedi (a.s) ia ktheu: "Kthehu tek prindërit e tu dhe qeshu atyre, ashtu siç i bërë të qajnë!"

Pejgamberi i Zotit nuk do që dikush të qajë, të mërztet apo të jetë fatkeq. Përkundrazi, ai do që në secilën zemër

KUJDESI I HZ. MUHAMMEDIT (A.S) NDAJ TË MOSHUARVE DHE TË VARFËRVE

SJELLJA E TIJ PROFETIKE ISHTE E TILLË QË GJITHMONË REFLEKTONTE MËSHIRËN DHE RESPEKTIN NDAJ BOTËVE, E SIDOMOS NDAJ BOTËS NJERËZORE.

njerëzore të mbjellë gëzim, dashuri dhe prehje, prandaj dhe e kthen të riun që të kujdeset për prindërit, pasi që e di fort mirë se sa dhëmbin lotët e prindërve për fëmijët e tyre.

Kjo është një, kurse tjetra, vetë kthimi i disa njerëzve nga lufta që të kujdesen për familjen apo për prindërit, dëshmon qartë se përpjekja apo lufta në Islam bëhet vetëm atëherë kur të kompletohet kujdesi dhe mbrojtja e familjes.

Është i çuditshëm fakti se si disa njerëz mund të luftojnë në emër të mbrojtjes së vlerave islame, ndërkohë që familjen e kanë të pa udhëzuar në mësimet dhe praktikën e fesë. Vetë fakti që Muhammedi (a.s) ndërroi jetë në gjirin familjar, (e që s'do mend se kjo është vetëm më kader të Allahut), flet për rëndësinë e madhe që ka kujdesi ndaj familjes, e sidomos ndaj prindërve të moshuar.

Nga ana tjetër, Muhammedi (a.s), gjithmonë kujdesej që të mos shqetësonte zemra, respektivisht të mos ua ngushtonte shpirtin njerëzve. Sjellja e tij profetike ishte e tillë që gjithmonë reflektonte mëshirën dhe respektin ndaj botëve, e sidomos ndaj botës njerëzore.

Muhammedi (a.s), përpos që fliste drejtë dhe me urtësi, ai orvatej, që me veprën e tij, të lërë gjurmë pozitive dhe impresionuese tek bashkëbiseduesi, apo tek personi me të cilin kishte një marrëdhënie, qoftë ajo fetare, shoqërore, tregtare, apo e ndonjë natyre tjetër.

Njëherë i erdhi një njeri i varfër por

që, në shenjë respekti dhe dashurie, i kishte sjellë një frut. Për çudi, Pejgamberi (a.s), e kishte ngrënë të gjithin, por pa u dhënë shokëve të pranishëm. I varfëri duke e parë gjestin e të Dërguarit, ishte larguar nga mjedisi i tyre me shumë kënaqësi. Mirëpo, meqë shokët e tij, as'habët e bekuar, (Zoti qoftë i kënaqur me ta), nuk ishin mësuar me një sjellë të tillë të të Dërguarit të Allahut, (a.s), njëri e pyeti: "O Pejgamberi i Allahut, e hëngre vetë frutin dhe ne të pranishmëve nuk na ofrove gjë?"

Pejgamberi (a.s), buzëqeshi dhe tha: Fruti ishte shumë i tharët. Sikur t'u ofroja juve, do ta kishit shprehur pakënaqësinë në fytyrën tuaj (do të ishit dukur qesharak), kështu që unë nuk doja që t'ia lëndoja ndjenjat njeriut të varfër. Prandaj, mendova me vete se është më mirë që ta haja atë frut me gëzim e ta kënaq njeriun, se sa ta lëndoja atë në ndjenja."

Kjo sjellje e të dashurit tonë, Muhammedit (a.s), me njerëzit e kategorive të ndryshme sociale, është vetëm një pikë uji në oqeanin e pafund të mëshirës, kujdesit dhe dashurisë së madhe që kishte, gjithmonë, ndaj ymmitit në veçanti dhe ndaj njerëzve në përgjithësi.

Selami qoftë për Muhammedin (a.s), për familjen, për shokët dhe për të Ummetin e tij.

(me përshtatje nga: islampress.info)

Kjo sjellje e të dashurit tonë, Muhammedit (a.s), me njerëzit e kategorive të ndryshme sociale, është vetëm një pikë uji në oqeanin e pafund të mëshirës, kujdesit dhe dashurisë së madhe që kishte, gjithmonë, ndaj ymmitit në veçanti dhe ndaj njerëzve në përgjithësi.



Arben Halluni, teolog

Në Kur'an thuhet: "O ju njerëz, vërtet Ne ju krijuam juve prej një mashkulli dhe një femre, ju bëmë popuj e fise që të njiheni ndërmjet veti, e s'ka dyshim se tek Allahu më i nderuar ndër ju është ai që më tepër është ruajtur (këqijave) e Allahu është shumë i dijshtëm dhe hollësisht i njohur për çdo gjë."¹

Krijuesi i gjithësisë me anë të ajetit të lartpërmendur u drejtohet qartazi të gjithë njerëzve pa përjashtim, të bardhit e të ziut, të pasurit e të varfrit, të fortit e të dobëtit, sundimtarit e të sunduarit, duke u treguar se të gjithë janë të barabartë në origjinën e krijimit. Të gjithë, qoftë mashkull apo femër, janë të barabartë në mes të barabartëve, ku secili prej tyre identifikohet te një popull apo fis. Ecuria e tyre është e komanduar me ligjin e bashkimit dhe domosdoshmërisht duhet të njihen në mes veti.

Allahu (xh.sh) ka vendosur një kushtetutë, me anë të së cilës ka qartësuar, se të gjitha krijesat në këtë botë përpara Zotit të tyre janë të njëjtë, dallohen vetëm me anë të shkallës së devotshmërisë. Devocioni tek Allahu (xh.sh) është çdo gjë që mund të marrë nga robërit e Tij. Sado që të shtohet pasuria nuk ka peshë te mizani (peshorja) Allahut Fuqplotë, sado që forca të jetë e madhe nuk ndikon asgjë në vendimin e Krijuesit të universit dhe sado, që një gjini të sundojë mbi një gjini tjetër, nuk do të merret në konsideratë nga Zoti Madhniplotë.

Ajo që do të merret parasysh nga

1. Kur'ani, El-Huxharatë: 13.

Ç'KA E DALLON NJERIUN?

Allahu (xh.sh) është devotshmëria, e cila është themel i Ditës së Llogarisë. Pikërisht për këtë thuhet në Kur'an: "S'ka dyshim se Allahu është me ata që janë të devotshëm (që ruhen prej të këqijave) dhe me ata që janë bamirës."² Ky ajet kuranor ka qenë deklarata e parë në historinë e të drejtave të njeriut, i pari konfirmim për nderimin e njeriut dhe e para iniciativë për të drejtën e barazisë midis njerëzve, pa marrë parasysh racën, gjininë, besimin, kombin, gjuhën etj.

Përpara Islamit njerëzit kanë qenë të ndarë në sundimtarë tiranë dhe në të sunduar si kafshët. Jo vetëm kaq por historia ka përmendur se perandoria romake ka qenë e ndarë në dy bashkësi: të lirët, të cilët kanë qenë vetë romakët dhe robërit e tyre, të cilët kanë qenë të gjithë popujt e tokës. Kështu ka vepruar edhe perandoria bizantine etj.

Me ardhjen e dritës së pashuar të Islamit, u shpall vendimi i prerë rreth problemit të diskriminimit racor midis njerëzve mbi bazën e gjinisë, ngjyrës, prejardhjes etj. Një hadith i profetit Muhammed (a.s), thotë: "Njerëzit janë të gjithë bijtë e Ademit dhe Ademi është prej dheut."³ Gjithashtu Islami ndaloi ndarjen raciste mbi bazën e pasurisë, pozitës e forcës, sepse të gjitha këto janë dhunti të përkohshme, sepse janë nga materia e botës dhe bota është drejt shuarjes.

Njerëzit mund të dallohen vetëm mbi bazën e vlerave të përhershme dhe koncepteve të Ahiretit mbi të cilat qëndron fati i të gjithë njerëzve. "Ditën kur nuk bën dobi as malli, as fëmijët. (bën dobi) Vetëm kush i paraqitet Zotit me zemër të pastër."⁴

Të gjithë njerëzit sado që të kenë dallime në rrizqet dhe në potencialet e tyre materiale janë të barabartë si dhëmbët e krëhërit. Kjo ka vlejtur për Hz. Omerin kurejshit, për Bilalin etiopian, për Suhejbën romak, për

2. Kur'ani, En-Nahl: 128.

3. Transmetuar nga Ebu Davudi dhe Tirmidhiu.

4. Kur'ani, En-Nahl: 88-89.

"O JU NJERËZ:

NË TË VËRTETË ZOTI JUAJ
ËSHTË NJË, BABAI JUAJ
ËSHTË NJË, NUK KA DALLIM
ARABI NDAJ JOARABIT,
AS JOARABI NDAJ ARABIT,
AS I KUQI NDAJ TË ZIUT,
E AS I ZIU NDAJ TË KUQIT
VETËM ME DEVOTSHMËRI,
S'KA DYSHIM SE
MË I NDERUARI TEK ALLAHU
ËSHTË AI
QË KA FRIKËN E TIJ."

Selmanin persian, por edhe për Hz. Muhammed Musatafanë (a.s), ku për këtë të fundit, një ajet kuranor thotë: "Thuaj: Unë jam vetëm njeri, sikurse edhe ju."⁵

Nga ana tjetër feja Islame e ka vendosur nderin e njeriut sipër të gjitha dobive lëndore dhe interesave ekonomike. Njeriu është i pari nga të gjitha krijesat. Për të është krijuar çdo gjë. Ai është zotëria i të gjitha krijesave. Asgjë në këtë botë të përkohshme nuk mund ta robërojë atë përveç Allahut (xh.sh), kështu që nuk duhet që njeriu të jetë rob i njeriut, sepse njeriu nuk mund të bëhet zot kur ai është i krijuar. Kështu shumë popuj e kanë njohur kuptimin e barazisë së drejtë nën hijen e Thirrjes Islame. Shumë njerëz kanë hyrë në Islam grupe-grupe, të zinj e të bardhë, të verdhë dhe të kuq, për shkak se në Islam kanë gjetur thirrjen e lirit nga robëria, thirrjen e heqjes së shtresave zotëruese dhe thirrjen e heqjes së dallimeve individuale. Profeti Muhamed (a.s) ka thënë në një citat të tij profetik: "Kush cenon (me ndarje raciste) një mysliman ai do të ketë mallkimin e Allahut, melekëve

5. Kur'ani, Fussilet: 6.



Xhahid Bushati, *shkrimtar*

Qyteti im, Shkodra është shquar edhe për bibliotekat e saj. Kjo shquarsia e ardhur nga rrezatimi i librave, si në heshtje, si në trazime, si në realitete të ashpra e dramatike, Shkodrës ia ka ndritur fytyrën!

Rrallë qytet, si ky i Vendlindjes sime, mund të shfaqet me nurin e hënës së mahnitshme librorë. Nderim emër për emër të gjithë atyre që shkruan qoftë edhe një fjalë të ndritshme për Shkodrën, ndritshmëri e barazvlefshme me hapjen e një dritareje për të parë civilizimin dhe qytetërimin e botës.

Në mes të biblioteka, e pasur e, sidomos në libra në gjuhët e Lindjes në fillim të shekullit të 19-të, ishte edhe ajo me emrin Biblioteka Këllici apo Tabaku. 150 vjet më parë ajo kishte mbi 3000 libra të dijeve të ndryshme dhe shumë dorëshkrime të vlefshme. Biblioteka ndodhej në lagjen e Tabakëve pranë kalasë Rozafa. Ishte një ndërtesë dykatëshe,

dhe të gjithë njerëzve!”⁶

Fakte për këtë ka shumë dhe dihen. Më e çuditshme është se kemi dëgjuar më përpara për njoftime të shkruara në portat e vendeve të publike në disa vende: “Ndalohej hyrja e zezakëve dhe e qenve”. S’ka dyshim se ky lloj diskriminimi racist është i kundërt me atë që ka sjellë Islami, feja jonë e pastër. Besimi ynë i ka dhënë njeriut nderin me anë të cilit jeton ballë-hapur. Islami është fé që i ka mësuar

6. Transmetuar nga Muslimi.

PAK HISTORI E FJALË LIBRI PËR NJË BIBLIOTEKË TË ÇMUESHME QË U DOGJ...

e pajisur me mjete e orendi dhe me fonde të ruajtura mirë. Shumë të huaj që kanë vizituar Shkodrën kanë shkruar edhe për këtë bibliotekë që erdhi duke e rritur fondin e librave. Kjo bibliotekë konsiderohet edhe vend historik, sepse këtu ka bërë mbledhjet më të rëndësishme Komiteti i Degës së Shkodrës i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1878-1881). Drejtuesi i kësaj biblioteke Isuf Tabaku (1797-1905) njeri i ditur dhe patriot, ka meritën kryesore në krijimin, mbajtjen e pasurimin e saj. Kështu ndodhi në historikun e kësaj Biblioteke, historia të jetë pranë librit e libri të jetë pranë historisë. Isuf efendi Tabaku i mbështjellë me pelerinën e vërtetë të Lirisë rri krenar plot urtësi në shtatoren prej libri. Pak si rrallë mund të gjendet një figurë e tillë!

Dhe kështu i vazhdoi ditët kjo Bibliotekë që dritësonte dhe përhapte dritën e shumë hoxhallarëve të ditur, të shkencëtarëve të heshtur, të ulemave të vlerë, të shumë e shumë njerëzve të heshtur që dhanë e dhanë pafund dituri për mbarësinë e njerëzimit, të qytetit të tyre, duke e gdhendur atë përmes dritës së urtësisë. Rrallë mund të gjendet qytet si Shkodra ime me një gdhendje të tillë...

Shkodër, 05.01.2016



njeriut se universi është krijuar për t’i shërbyer atij. Islami është fé që i ka vendosur interesat ekonomike nën interesin e njeriut, mirëpo ajo çka po ndodh realisht është se diskriminimi racist ka vendosur ekonominë mbi njeriun dhe më keq është bërë zotëria e njeriut nënshtrues.

Detyra jonë ndaj këtyre njerëzve të shtypur, pavarësisht doktrinës fetare, racës, ngjyrës etj, është e njëjta detyrë që kemi ndaj fesë sonë, për të cilën jemi të obliguar të ftojme njerëzit

drejt barazisë, harmonisë paqësore dhe bashkëpunimit pa dallime...

I Dërguari i Allahut (a.s) në Haxhin e Lamtumirës ka thënë: “O ju njerëz: Në të vërtetë Zoti juaj është një, babai juaj është një, nuk ka dallim arabi ndaj joarabit, as joarabi ndaj arabit, as i kuqi ndaj të ziut, e as i ziu ndaj të kuqit vetëm me devotshmëri, s’ka dyshim se më i nderuari (më i dalluari) tek Allahu është ai që ka frikën e Tij (pra ruhet nga të ligat)”.

AKTIVITETE GJATË MUAJ



E TË BEGATA IT JANAR...



Smajl Bala, *studiuues*

Eshtë lindur në qytetin e Shkodrës, në një familje me tradita fetare. Kontributi i tij në fushën e arsimit dhe të pikëpamjeve përparimtare ia rrisin edhe më shumë traditat kësaj familjeje të nderuar.

Prindërit, bashkë me moshatarët e tjerë të lagjes, e çuan në mejtepin e xhamisë, ku shpejt do të dallohej mes tyre për zellin e përvetësimit të Islamit. Më pas regjistrohet në shkollën “Ruzhdije” e në Medresenë e Pazarit të Vjetër.

Krahas çdo gjëje që i takonte një institucioni arsimor, Abaz Golemi arriti një përvetësim maksimal të lëndëve teologjike e të kulturës së përgjithshme, por edhe të ideve atdhetare të kohës.

Zotëronte si s’ka më mirë gjuhët kryesore të Lindjes, si arabishten, persishten e turqishten dhe me këtë formim solid ai i drejtohet Stambollit, ku ndjek e përfundon studime më të thelluara teologjike në shkollat e atjeshme. Por as kjo nuk i mjaftoi, regjistrohet dhe vazhdon pa ndërprerje edhe katër vjet të tjera, por kësaj radhe në Medresenë e Lartë Pedagogjike të Stambollit.

Gjatë studimeve kishte fituar edhe titullin “Hafiz”, veç teologjisë, qe pajisur edhe me dije të shkencave të kulturës së përgjithshme e me gjuhë të tjera të huaja, si frëngjishten, italishten e serbokroatishten, të cilat i zotëron me të shkruar e me të folur, duke u kthyer kështu në një poliglot.

Kthehet në qytetin e lindjes, në Shkodër. Fillimisht emërohet si mësues i persishtes dhe i besimit në shkollat e qytetit të Shkodrës, ku punon deri në vitin 1912. Në vitin 1913, kur komisioni i arsimit të Shkodrës hap tri shkolla laike, në njërin prej tyre, e pikërisht në atë të Parrucës, drejtor i parë emërohet Haxhi Hafiz Abaz Golemi. Ai qe gjithnjë drejtor i kësaj shkolle, edhe kur qe gjimnaz i ulët (1913-1916), shkollë fillore (1916-1918), shkollë qytetëse, ose shkollë plotore me 6 klasa.

Me aftësitë e tij drejtuese e organizuese

HAFIZ ABABZ GOLEMI (1870-1925)

dhe duke pasë në krah mësues të tillë si Sheuqet Muka, Gani Dizdari, Rustem Lopçi, Hamdi Bushati etj, bëri që shkolla të marrë një emër mjaft të mirë dhe thuajse të gjithë qytetarët kishin dëshirë t’i shkollonin aty fëmijët e tyre, edhe pse kapaciteti i saj nuk i përballonte dot. Shkolla e Parrucës shpejt u kthye në një vatër dijeje, përparimi dhe emancipimi shoqëror. Me punë të përbashkët, ky staf i mrekullueshëm pedagogjik, arriti të ulë në bankat e shkollës nxënës të familjeve shkodrane të të tre besimeve fetare, çka përbënte një risi në jetën e këtij qyteti me aq tradita tolerance e bashkëjetese fetare.

Mati Logoreci, drejtor i arsimit në Shkodër, më 3 nëntor të vitit 1917 për të shkruan: “Qyshkur merret me degë të arsimit, këtij njeriu me ndikim të madh



HAFIZ ABABZ GOLEMI (1870-1925)

i shenova korona 200, kur një mësues e kishte 120 korona”.

Kristo Roka, inspektor i përgjithshëm i MA, pas inspektimit të tij në shkolla të Shkodrës në vitin shkollor 1920-21, për Haxhi Hafiz Abaz Golemin dhe shkollën që ai drejton, shkruan: “Është një nga më të mirët që kemi në Shkodër... Drejtori i shkollës Haxhi Hafiz Abaz Golemi mban rregull të mirë dhe tregon një përkujdesje të veçantë për pastërti dhe për disiplinë, si me trupin e mësuesve dhe midis nxënësve”.

Gaspër Beltoja, në emër të IASH, në vitin shkollor 1924-25 jep këtë konsideratë për të: “Përsa e njohim në kohën 12 vjeçare, mund të vërtetojmë se ai përherë qe drejtor i shkollës së Parrucës dhe përherë gëzonte një famë të mirë në popull, sa që fëmijët prej të tana lagjeve e marrin mbrapa dhe mund të themi se shkolla e Parrucës asht sot nji frut i tij”.

Hafiz Abaz Golemi, veçse hoxhë e

mësues, qe edhe një patriot i flaktë. Madje ai rroku edhe pushkën në mbrojtje të qytetit të tij, Shkodrës, ndaj sulmeve serbo-malazeze të vitit 1912-13, duke u renditur përkrah luftëtarëve të tjerë në istikamet e bardhanjorëve. Atje ku lufta ishte më e rreptë do të dëgjoje zërin e tij burrëror duke u dhënë zemër trimave për të mos lëshuar asnjë pëllëmbë tokë.

Mbas 12 viteve, në vitin 1924, pushohet nga puna dhe arrestohet për pikëpamjet e tij politike nga qeveria e kohës, së bashku me Hafiz Halil Pukën, Sheuqet Mukën e Rustem Lopçin. Me ndërhyrjen e IASH e të Gaspër Mikelit, u arrit që të liroheshin e të ktheheshin në krye të detyrës.

Por veprimtaria arsimore e politike e tij vlerësohen edhe pas vdekjes. Edhe për këtë po i drejtohem disa të vërtetave e thënieve të personaliteteve e institucioneve:

Drejtorja e Arsimit të Shkodrës, në një letër që i dërgon MA për t’i lidhur pension familjes pas vdekjes së tij, mes tjerave shkruan: “Haxhi Hafiz Abaz Golemi ka qëndruar në këtë degë 30 vjet, një arsimtar i vjetër... Qe burrë në fjalë e burrë në vepra, me ndërgjegjen e tij qe shembull... Mjafton të themi se në varrimin e tij, përveç se mori pjesë e gjithë Shkodra padyshim bashkë me trupin mësues, mori pjesë edhe populli mbarë... Pra, nuk dyshojmë se për një arsimtar kaq të vjetër, për një arsimtar kaq të vyer të bjerrun para kohë, nuk dyshojmë të kurset ajo P.T. - Drejtorja e Arsimit për familjen e të ndjerit Haxhi Hafiz Abaz Golemi, që vdiq nga një sëmundje në zemër, që iu shkaktue prej hallesh e idhnimesh”.

Do të kalonin vite e dekada derisa aktiviteti i tij në fushën e arsimit shqiptar e më gjerë do të merrte vlerësimin e merituar, kur më 19 qershor të vitit 1993, me rastin e 80-vjetorit të shkollës së Parrucës (sot “Ismail Qemali”), Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Sali Berisha, do t’i akordonte titullin e lartë “Mësues i Popullit”, me këtë motivacion: “Mësues dhe drejtor i shquar, që punoi me pasion tërë jetën për edukimin dhe formimin moral e qytetar të nxënësve, për ngritjen e përparimit shoqëror, shembull devotshmërie e përkushtimi ndaj idealeve njerëzore për mirëkuptim, bashkëpunim e drejtësi shoqërore, që themeloi e drejtoi plot efektivitet shkollën e Parrucës në agimet e arsimit tonë shtetëror”.

Haxhi Hafiz Abaz Golemi u nda nga kjo jetë në vitin 1925.



Naim Drijaj,
imam - xhamia Parrucë

Imam Buhariu ka vënë si kapitullin e parë në librin e tij “Edebul Mufred” kapitullin e titulluar “Edukata ndaj prindërve” duke përmendur në të ajetin: “Ne e kemi urdhëruar njeriun të sillet mirë me prindërit e tij...”¹ dhe hadithin e transmetuar nga Abdullah ibn Mesudi (r.a) se: E kam pyetur të Dërguarin e Allahut (a.s), se cila është vepra më e dashur tek Zoti? Ai më tha: “Namazi në kohën e vet”. I thashë: Po pastaj? Më tha: “Respektimi i prindërve”. I thashë: Po pastaj. Më tha: “Xhihadi në rrugë të Allahut”².

Si rezultat i largimit nga mësimet hyjnore, njeriu dhe shoqëria po kalojnë një jetë të trazuar, ku nëpërkëmben vlerat dhe gjithnjë e më shumë bihet në shfrenim moral. Në këto ditë të materializmit të egër, në zemrat e njerëzve mungon drita e imanit dhe dominon errësira që shkakton një gjendje të rëndë mendore, boshllëk shpirtëror dhe me mungesë humanizmi.

Sot ka raste kur fëmijët nuk përkujdesen për prindërit e tyre, por i lënë ata nën përkujdesjen e institucioneve sociale, sikurse është azili i pleqve duke i privuar ata nga kujdesi dhe ngrohtësia që duhet të tregohet ndaj prindërve. Madje nuk janë të rralla rastet kur fëmijët ushtrojnë dhunë psikike e fizike ndaj prindërve.

Nuk duhet të harrojmë faktin se të gjithë jemi fëmijët e dikujt, prandaj le të kemi kujdes me prindërit tanë e të mos sillemi me ta ashtu siç nuk duam që fëmijët tanë të sillen me ne.

Përditë shohim e dëgjojmë raste të frikshme, por na është bërë zemra gur, na janë bllokuar veshët, na janë zënë

RESPEKTI NDAJ PRINDËRVE ËSHTË POROSI HYJNORE

sytë dhe asgjë nuk na bën përshtypje.

SJELLJA E MIRË ME PRINDËRIT VJEN MENJËHERË PAS BESIMIT NË ALLAHUN E MADHËRUAR:

“Zoti yt ka urdhëruar, që të mos adhuronit askënd tjetër përveç Atij dhe të silleni mirë me prindërit. Nëse njëri prej tyre ose të dy arrijnë pleqërinë te ti, mos u thuaj as “uh”, mos i kundërshtoj, por drejtoju atyre me fjalë respekti”³.

1. RESPEKTIMI I PRINDËRVEBHET SHKAK QË MOS TË NA BIEN MBI KRYE FATKEQËSI TË NDRYSHME.

Argument për këtë është ngjarja e tre personave që kishin hyrë në shpellë dhe një gurë i madh kishte rënë duke e mbyllur hyrjen e shpellës. Në këtë gjendje, secili prej tyre iu lut Allahut me nga një punë të mirë që kishin bërë për hir të Tij. Njëri prej tyre iu lut Zotit duke përkujtuar respektimin e prindërve: “O Zot, Ti e di që unë kam pasur prindërit e moshuar dhe fëmijët e vegjël. Sa herë që milja bagëtinë, nuk u jepja fëmijëve qumësht para se të pinin prindërit. Një natë u vonova me bagëtinë në kullotë dhe kur shkova t’u çoj qumështin prindërve, i gjeta duke fjetur. Megjithatë fëmijët qanin nga uria, unë nuk u dhashë pasi e kisha bërë zakon që të pinin prindërit të parët. Qëndrova me enën me qumësht te koka e tyre derisa u zgjuan në mëngjes. Pasi pinë prindërit, ushqeva fëmijët e mi. “O Zot, nëse këtë vepër e kam bërë për hatrin Tënd dhe për të arritur shpërblimin Tënd, na e largo këtë shkëmb nga hyrja e shpellës”. Në atë çast shkëmbi lëvizi dhe të tre arritën të dalin jashtë nga shpella”⁴.

2. RESPEKTIMI I PRINDËRVE KONSIDEROHET XHIHAD.

Transmeton Abdullah ibn Amri (r.a) që ka thënë: “Erdhi një person tek i Dërguari i Allahut dhe i kërkoi leje Pejgamberit (a.s) që të merrte pjesë në Xhihad. Pejgamberi e pyeti: A i ke të gjallë prindërit? Ai iu përgjigj: Po. Pejgamberi (a.s) i tha: “Xhihadi yt është

*“KËNAQËSIA E ALLAHUT
ËSHTË NË KËNAQËSINË
E PRINDËRVE,
KURSE ZEMËRIM I ALLAHUT
ËSHTË NË ZEMËRIMIN
E PRINDËRVE!”*

kujdesi për prindërit”⁵.

3. RESPEKTIMI I PRINDËRVE ËSHTË SHKAK PËR HYRJEN NË XHENNET.

Transmeton Ebu Darda (r.a) se e ka dëgjuar Pejgamberin (a.s) duke thënë: “Prindërit janë dera e mesme e Xhenetit, pra nëse dëshiron fitojë atë derë ose humbe atë”⁶. Kushejri ka thënë: “..dera e mesme e Xhenetit, do të thotë, dera më e mirë e Xhenetit”.

4. KËNAQËSIA E ALLAHUT ËSHTË NË KËNAQËSINË E PRINDËRVE.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Kënaqësia e Allahut është në kënaqësinë e prindërve, kurse zemërim i Allahut është në zemërimin e prindërve”⁷.

Imam Shafi (r.h) tregon se kur ulej të hajë bukë, nuk hante derisa të përfundonte nëna e tij. Kur e pyetën rreth shkakut, u përgjigj: “Kam frikë se mos zgjas dorën të marr diçka që do të donte ta hante nëna ime”.

5. MOSRESPEKTIMI I PRINDËRVE ËSHTË NGA GJYNAHET E MËDHA.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “A dëshironi t’ju tregoj për gjynahet më të mëdha?” Këtë e përsëriti tri herë. Ne i thamë: Po, o i Dërguar i Allahut. Pejgamberi (a.s) tha: “Shirku i Allahut dhe mosrespektimi i prindërit...”⁸.

Pejgamberi (a.s) ka thënë: “Çdo gjynah Zoti mund ta shtyjë për jetën tjetër, ndërsa keqtrajtimin e prindërve Zoti e dënon që në këtë jetë”.

5. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

6. Transmetuar nga Tirmidhiu.

7. Transmetuar nga Tirmidhiu.

8. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.

1. Kur’ani, El-Ankebut: 8.

2. Transmetuar nga Buhariu në “Edebul Mufred”.

3. Kur’ani, El-Isra: 23.

4. Transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi.



Erjon Tusha

Korniza e mendimit islam paraqet një pamje të plotë të jetës dhe universit. Prandaj një mysliman është e nevojshme të marrë dy dije; fetare dhe të kësaj bote. Në fakt, Islami e mbrojtë dijen në një kohë kur e gjithë bota u ngulfatën në injorancë. Po të kthehemi në kohë, brezi i hershëm i muslimanëve u bë një popull i mësuar dhe i rafinuar. Për ta, Islami kishte zgjuar fakultetin e intelektit. Ata, muslimanët e hershëm, e kuptuan nga mësimet e fesë së tyre se dituria e dobishme është e nevojshme për të mirën vetjake dhe atë të njerëzimit. Për këtë arsye, ata e ndoqën atë në një shkallë të tillë, që ata të kenë tejkaluar kombet e tjera në zhvillimin e produktivitetit dhe kanë mbajtur pishtarin e qytetërimit për shumë shekuj.

Historia myslimane është e mbushur me shembuj të zgjuarsisë shkencore dhe kulturore. Muslimanët kanë trashëguar dijen nga kombet që kanë dalë para tyre, dhe e vendosën atë në kontekstin e një kornize të saktë morali. Dijetarët myslimanë dhanë një kontribut të rëndësishëm në pasurimin dhe përparimin e qytetërimit njerëzor.

Ndërsa Evropa ishte ende në periudhën e errët, muslimanët fetarë bënë përparime të mëdha në fushën e mjekësisë, matematikës, fizikës, astronomisë, gjeografisë, arkitekturës, letërsisë, historisë dhe dokumentacionit.

Shumë avancime të rëndësishme të reja u transmetuan në Evropën mesjetare nga rajonet myslimane, të tilla si: numra arabë për avancimin e matematikës dhe përdorimin në algjebër. Instrumente të sofistikuara, si dhe harta të mira lundrimit, u zhvilluan në fillim nga muslimanët.

Në mënyrë të ngjashme, Islami sot nuk e kundërshton ndonjë shpikje moderne që është bërë e dobishme për

PIKËPAMJA E ISLAMIT NË LIDHJE ME ARSIMIN, SHKENCËN DHE TEKNOLOGJINË

*“THUAJ:” A JANË TË BARABARTË ATA QË DINË
ME ATA QË NUK DINË?” - (Kur’ani, Ez-Zumer: 9)*

njerëzimin. Është e mjaftueshme që ato të përdoren në emër të Zotit dhe për rrugën e Tij. Në realitet, makina, instrumentet dhe pajisjet elektronike nuk kanë fé apo atdhe. Ato mund të përdoren për objektiva të mirë, ose të këqij, dhe mënyra se si ato janë përdorur mund të ndikojë shumë jetën e popullsisë në tokë. Televizioni mund të sigurojë arsim ose imoralitet. Kjo është në dorë të përdoruesit për të vendosur, dhe një musliman është i urdhëruar për të bërë përdorimin e mirë të të gjitha mjeteve në dispozicion të tij, ndërsa i është ndaluar që t’i shkaktojë dëm vetes apo të tjerëve. Dështimi për të përdorur mjetet e duhura drejt përfitimit është, në fakt, një zhvlerësim i mësimave islame.

Avancimet në shkencë dhe teknologji janë ndër mënyrat dhe mjetet për të arritur zhvillimin e botës myslimane. Islami i bën thirrje muslimanëve për ti ndjekur këto njohuri në kuptimin më të gjerë të fjalës. Profeti Muhamed ka thënë: “Kërkimi i diturisë është obligim për çdo musliman.”¹ Ai gjithashtu ka thënë, “Sepse ai që ecën në një rrugë të dijes, Allahu do të bëjë të lehtë për të rrugën për në Xhennet.”² dhe Kur’ani përmban referenca të shumta për njohuri dhe rëndësinë e saj, të tilla si:

“Në të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të tokës dhe ndërrimin e natës e të ditës ka argumente për ata që kanë mend.”³

“Thuaj:” A janë të barabartë ata që dinë me ata që nuk dinë?”⁴

“Allahu do t’i lartësojë ata që kanë besuar dhe atyre që u është dhënë dituri, me gradë.”⁵

Ajetet kur’anore inkurajojnë studimin dhe soditjen e universit që na rrethon dhe është veçanërisht i shqetësuar me ato shkenca që i japin qenieve njerëzore, aftësinë për të përfituar nga bota rreth tyre. Ndërsa duke inkurajuar

hulumtimin, Kur’ani përmban referenca në një shumëllojshmëri të subjekteve të cilat janë treguar të jenë shkencërisht të sakta. Kjo është përmbushja e deklaratës së Zotit mbi 14 shekuj më parë:

“Ne do të tregojmë atyre argumentet Tona në horizonte dhe në veten e tyre derisa të bëhet e qartë atyre se kjo është

*“NË TË VËRTETË,
NË KRIJIMIN E QIEJVE
DHE TË TOKËS
DHE NDËRRIMIN
E NATËS E TË DITËS
KA ARGUMENTE
PËR ATA
QË KANË MEND.”*

e vërteta.”⁶

Kështu, kur një musliman ka një qëllim të sigurt dhe të shëndetshëm për të marrë njohuri, ajo gjithashtu do të ketë një efekt pozitiv në besimin e tij.

Nuk ka qenë kurrë një fakt shkencor, në kundërshtim me mësimet e Islamit. Çfarëdo që shkenca moderne zbulon vetëm rrit njohuritë e muslimanëve. Kështu, Islami në mënyrë aktive inkurajon përpjekjet shkencore dhe studimin e shenjave të Zotit në natyrë. Ai gjithashtu përshëndet përparimet teknologjike të dobishme dhe lejon njerëzit të gëzojnë frytet e zgjuarsisë së tyre.

Për një musliman, konflikti ndërmjet shkencës dhe fesë është një pamundësi. Islami mbron përfshirjen e njohurive brenda një sistemi të drejtë dhe të balancuar të vlerave, ku çdo gjë e dobishme për përmirësimin e gjendjes shpirtërore të kësaj bote është e inkurajuar dhe përkrahur.

6. Kur’ani, Fussilet:53.

1. Transmetuar nga Ibn Maxhe.
2. Transmetuar nga Muslimi.
3. Kur’ani, Ali Imran: 190.
4. Kur’ani, Ez-Zumer: 9.
5. Kur’ani, El-Muxhadele: 11.

Të enjten, më 31 dhjetor 2015, “Dersi i natës së enjte”, pas namazit të akshamit, u zhvillua në xhaminë e Tophanës.

Pas namazit të akshamit me xhemat, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mbajti dersin e kësaj mbrëmje, ku foli mbi rëndësinë që ka përkujtimi i vazhdueshëm i personalitetit dhe mesazhit të Hz. Muhammedit (a.s).

Myftiu u ndal te një detaj, për të cilin tha se, prej shumë vitesh, sa herë afrohet muaji Rebiulevvel, ku përkujtojmë Lindjen e Begatë të Hz. Muhammedit (a.s), një virus dashakeq, i prodhuar në laboratorët e jomuslimanëve, nis e përhapet në realitetet islame, për t'i kthyer muslimanët në taborra që kundërshtojnë njëri-tjetrin, deri në etiketime me blasfemi, dalje nga feja, etj.

Ai tha, se këtë virus duhet ta vrasim me injorimin e tij, me neglizhencën tonë ndaj prezencës së tij, si dhe përhapjen me sa të kemi mundësi të mesazheve qytetëruese që vijnë nga zemra e Hz. Muhammedit (a.s), për lindjen e të cilit duhet të gëzohemi e të festojmë, sikurse urdhërohem edhe në Kur'anin Famëlartë.

Myftiu theksoi se ditëlindjet e profetëve janë data të shënuara për

“DERSI I MBRËMJES SË ENJTE” NË XHAMINË E TOPHANËS



mbarë njerëzimin, sikurse përmendet edhe në Kur'an, prandaj, duhet të kuptojmë se përsëritja e tyre vit pas viti, është një mundësi më tepër për t'u rikthyer te leximet intensive të jetës së secilit prej tyre dhe praktikimit në jetë të traditave të tyre, sidomos ato të Hz.

Muhammedit (a.s), që u dërgua mëshirë për mbarë botrat.

Projekti “Dersi i mbrëmjes së enjte”, do të vazhdojë edhe në xhamitë e tjera të Shkodrës, gjatë javëve në vazhdim, sipas një programi të parapërgatitur.

GJALLËRIMI I XHAMISË, MYFTIU TAKON IMAMË TË QYTETIT

Paraditën e së enjtes, më 7 janar 2015, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, zhvilloi një takim pune me një grup imamësh të qytetit, me të cilët bashkëbisedoi dhe dha udhëzime rreth gjallërimit të jetës fetare në xhami, por jo vetëm.

Gjatë fjalës së tij, Myftiu tërhoqi vëmendjen e imamëve se realiteti i kohës, po imponon më shumë se asnjëherë tjetër nevojën e madhe për gjallërimin e jetës fetare në xhamitë e vendit, si dhe kujdesin ndaj fjalës, mesazhit dhe udhëzimit fetar që jepet, në mënyrë që ai të jetë sa më tërheqës, gjithëpërfshirës, plot urtësi.

Për këtë, Myftiu udhëzoi që tashmë që kemi kaluar edhe muajin e Mevludit Sherifë, duhet të shtohen sa më tepër tribunat, vaset, takimet e ngushta, bashkëbisedimet e takimet e ndryshme me besimtarët, për të diskutuar e folur rreth dashnisë dhe mesazhit hyjnor të Hz. Muhamemdit (a.s). Ai tha se sot, shoqëria ka nevojë për alternativa të reja, për ta bërë fenë sa më të dashur dhe sa më afër jetës së njerëzve.

Myftiu tha se imamët duhet ta ruajnë e ta mbajnë me dinjitet amanetin e Thirrjes



Islame dhe detyrën që i është besuar nga Myftinia, në shërbim të vlerave të fesë dhe ruajtjes së harmonisë, rregullit, disiplinës institucionale dhe mbrojtjes së traditave shekullore.

Gjatë këtij takimi, u diskutua edhe për tema të shumta që lidhen

me jetën e xhamisë, harmoninë në mesin e besimtarëve, distancimin nga ekstremizmi dhe tendenca e fanatizmit të verbër, që ka për tendencë të shfaqet, kudo e përherë, sidomos në ambiente ku dominon injoranca, mungesa e edukatorit dhe leximet e gabuara të teksteve fetare.

XHAMIA E MEDRESESË, PËRKUJTOHET LINDJA E BEGATË E HZ. MUHAMMEDIT (A.S)



Pasdreken e së enjtes, më 7 janar 2015, Myftinia Shkodër në bashkëpunim me drejtorinë e Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", ka organizuar në xhaminë e Medresesë një tribunë fetare, në përkujtimit të Lindjes së Begatë dhe dërgesës profetike të HZ. Muhammedit (a.s).

Në fjalën e tij përshëndetëse, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, theksoi se organizimi i këtyre tubimeve po bëhet përherë e më i domosdoshëm, duke marrë parasysh injorancën e madhe dhe mungesën e njohurive që njerëzit kanë rreth personalitetit dhe misionit të HZ. Muhammedit (a.s).

Myftiu theksoi se edhe nxënësit e Medresesë duhet të jenë përherë e më aktivë, kur bëhet fjalë për muajin Rebiulevvel, ku mbarë bota islame përkujton Mevludin Sherifë dhe mirësitë e mëdha që i erdhën botës me lindjen dhe dërgesën e HZ. Muhammedit (a.s).

Edhe drejtori i Medresesë "Haxhi Sheh Shamia", z. Kujtim Dervishi, në fjalën e tij, tha se këto aktivitete kanë një rëndësi të madhe, pasi na afrojnë përherë e më shumë me besimin dhe vlerat e tij në jetë. Ai tha se përkujtimi i lindjes së HZ.

Muhammedit (a.s) është një shprehje e dashurisë dhe respektit që kemi ndaj të dërguarit të All-llahut.

Aktiviteti vijoi me ligjëratat e dobishme të mbajtura nga imamët e nderuar, teologu Idmir Plaku dhe teologu Naim Drijaj.

Në ligjëratat e tyre, imamët e nderuar hodhën dritë mbi vlerat e leximit dhe kuptimit të jetës së HZ. Muhammedit (a.s), nevojën e madhe që kanë xhematet dhe shoqëria e sotme për ndjekjen e traditave të profetit (a.s), si dhe vlerësimin e madh që i ka bërë Zoti i gjithësisë të dashurit të Tij, HZ. Muhammedit (a.s).

Në ligjëratat në fjalë, u hodh dritë edhe mbi respektin e madh që ka treguar vetë i dërguari (a.s) për ditën e lindjes së tij, si një mirësi dhe begati hyjnore nga Zoti për gjithësinë.

U dhanë shembuj të goditur nga jeta e sahabëve dhe dashuria e tyre e madhe për HZ. Muhammedin (a.s), si dhe u bënë lutje që Zoti i gjithësisë të na forcojë në rrugën e dërguarit të Tij dhe Kur'anit Famëlartë.

Për kënaqësinë e të pranishëmve, u kënduan edhe disa ilahi nga medresistët tanë.



"MOS U BËJ PESIMIST

NGA VËSHTIRËSIA

E RRUGËS, SEPSE

"ES-SIRATUL-MUSTEKIM"

"RRUGA E DREJTË"

QËNDRON MBI XHEHNEM

DHE, ËSHTË E VETMJA

QË TË SHPIE

NË XHENNET!"

Dr. Sahabudin A. Kestaro
Damask, Siri

“HZ. MUHAMMEDI (A.S), MËSHIRA E DHURUAR”, NË XHAMINË E “DY VAJZAVE”



Të enjten, më 7 janar 2015, në kuadër të projektit: “Dersi i natës së enjte”, Myftinia Shkodër ka organizuar një bashkëbisedim me frekuentues të xhamisë së “Dy Vajzave” me temë: “Hz. Muhammedi (a.s), mëshira e dhuruar”.

Pas faljes së namazit të akshamit me xhema, nën drejtimin e imamit të kësaj xhamie, teologut Lavdrim Hamja, bashkëbisedimi në fjalë u përqendrua në disa pika referimi, si:

- Resulull-llahu (a.s), shembull në udhëzimin e muslimanëve drejt harmonisë komunitare.
- Resulull-llahu (a.s) dhe Kur’ani, si udhërrëfyes drejt paqes sociale.
- Modeli i muslimanit në marrëdhënie me vëllanë e tij musliman.
- Dituria e dobishme dhe praktikimi i saj në raport me shembullin profetik.
- Hz. Muhammedi (a.s), shembulli më i përkryer i mëshirës në jetë.

- Hz. Muhammedi (a.s), si praktikë konkrete e Kur’anit në shoqëri.

- Vlera e tubimeve ku përkujtohet Hz. Muhammedi (a.s) dhe shembulli i tij praktik, si shtysë drejt përvetësimit të këtij shembulli në jetë.

- Vlera e tubimeve komunitare, ku muslimanët bashkëbisedojnë dhe trajtojnë problematika të ndryshme të jetës së tyre.

Për këto pika diskutuan: Imam Muhamed B. Sytari (Myfti i Zonës Shkodër), teologu Ervil Kuçi (imam i xhamisë Dërgut), teologu Lavdrim Hamja (imam i xhamisë së “Dy Vajzave”).

Tubimi i kësaj mbrëmjeje fetare u shoqërua me ndërhyrje të shumta të besimtarëve të pranishëm si dhe me pyetje të larmishme në funksion të këtij bashkëbisedimi me vlerë.



**“LAVDINË
E SHEKUJVE
NUK E ZHBËN
MASKA
E MISIONARËVE
ME PUSHTET...
LAVDIA E SHEKUJVE
NUK VDES KURRË,
RIZGJIMI KA NISUR!”**

Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

MYFTIU REFEROI MBI FAMILJEN NË KUR'AN DHE TRADITAT PROFETIKE



Me ftesë të Shoqatës “Në familje për familjen”, ditën e hënë, më 18 janar 2016, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, ka referuar mbi familjen dhe nevojën e mbrojtjes së saj, në konferencën e organizuar nga shoqata në fjalë, në bashkëpunim me Komitetin Shtetëror për Kultet dhe Ambasadën e Kanadasë në vendin tonë.

Gjatë fjalës së tij, Myftiu vuri theksin te vlera e familjes në Islam, te respekti dhe përkujdesja e Islamit për femrën dhe fëmijën dhe domosdoshmëria e madhe e mbrojtjes së familjes në këtë kohë, kur komplete të shumta po cenojnë familjen muslimane dhe atë qytetare shqiptare.

Ndër të tjera, Myftiu tha se: “Sot, shpesh ndodh të përballemi me kështjella luksoze, në brendësinë e të cilave ka familje të shkatërruara! Shtëpi në kulmin e luksit, ku djali nuk flet me babën, e vajza nuk pyet më për nënën! Shkatërrim, si ai me të cilin përballemi ditë pas dite, kur dëgjojmë se djali vrau

babën, vajza u largua nga shtëpia me të dashurin, rritja e numrit të aborteve, nxitja e rinisë drejt alternativave imorale, që shpesh nxiten edhe nga institucionet tona, si rasti i festës së shkumës, para Bashkisë, Ramazanin që kaloi, a kolibet e alkoolit para xhamisë “Ebu Bekër”, këtë dhjetor që lamë pas! Të gjitha këto, e shumë më shumë se kaq, janë pjesë e një komploti të madh që i bëhet familjes së sotme muslimane shqiptare! Jo vetëm kaq, por, krejt familjes tradicionale qytetare me traditat shekullore të besimit, nderit, pastërtisë dhe moralit!”

Në këtë konferencë referuan edhe drejtuesit e dy kishave kryesore të Shkodrës, znj. Greta Bardeli, Kryetare e Këshillit të Qarkut Shkodër dhe znj. Zenepe Dibra, Kryetare e Shoqatës së Grave Intelektuale të Shkodrës.

Konferenca në fjalë u zhvillua në ambientet e bibliotekës së Universitetit të Shkodrës, në prani të shumë studentëve dhe pedagogëve pjesëmarrës.



"QYTETËRIMI EVROPIAN
NUK FILLOI NGA ITALIA,
POR NGA SPANJA,
NGA MODELI ISLAM.
AI PËR FAT TË KEQ,
NUK MORI
PREJ KËTIJ MODELI,
VEÇSE SHKENCËN
EKSPERIMENTALE
E TEKNOLOGJINË DHE
NEGLIZHOI PLOTËSISHT
VLERAT HYJNORE,
TË CILAT
DO TA DREJTONIN
KËTË QYTETËRIM
DREJT MIRËSISË
SË NJERËZIMIT".

Dr. Mustafa Mahmud

KRYETARI I KMSH, BASHKËBISEDIM ME MATURANTËT E MEDRESESË SHKODËR



Paraditën e së martës, më 26 janar 2016, H. Skender Bruçaj, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, zhvilloi një vizitë pune në Shkodër, ku kishte programuar vizitën e Medresesë “Haxhi Sheh Shamia” dhe një bashkëbisedim me maturantët e të dyja degëve.

I shoqëruar nga antarët e Kryesisë së KMSH, Dr. Genti Kruja, z. Astrit Zharri, si dhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, Kryetari i KMSH u prit nga z. Kujtim Dervishi, drejtor i Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, z. Ridvan Seferaj, kryetar i Shoqatës “Istanbul” dhe stafet e dy degëve të medresesë.

Fillimisht, Kryetari Bruçaj, zhvilloi një vizitë në objektin e ri të Medresesë, ku zhvillojnë mësim klasat e ciklit të ulët. Në vizitat e tij në disa prej klasave, Kryetari i KMSH, dha mesazhe të përzemërta për suksesin dhe mbarësinë e mësuesve në edukimin e brezit të ri me frymën e dashurisë për dijen dhe shkollën.

Më pas, vizita vijoi me bashkëbisedimin e organizuar nga drejtoria e shkollës, ku Kryetari i KMSH dha mesazhet dhe këshillat e tij për 150 maturantët e medresesë së

Shkodrës; për vazhdimin e studimeve dhe nxitjen për të perfeksionuar dituritë, në fushat e përzgjedhura për studime.

Kryetari Bruçaj tha se kushtet bashkëkohore që ofron Medreseja e Shkodrës dhe ato të krejt vendit, janë një mirësi e madhe dhe një shtysë më shumë për ta vlerësuar këtë begati të Zotit, me studim të vazhdueshëm dhe reflektimin e moralit të shkollës në realitetet e përditshme.

Kryetari i KMSH, rrëfeu edhe një pjesë të eksperiencës së tij personale, si ish-medresist dhe rëndësinë e madhe që ka mësimi dhe studimi në jetë.

Më pas, maturantët i drejtuan Kryetarit Bruçaj disa pyetje që lidhen edhe me të ardhmen e studimeve të tyre, pas përfundimit të Medresesë.

Më herët, maturantët i përshëndeti edhe Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, si dhe drejtori i Medresesë, z. Kujtim Dervishi.

Me rastin e kësaj vizite dhe takimi të përzemërt, H. Skender Bruçaj i dhuroi dy bibliotekave të Medresesë “Haxhi Sheh Shamia”, kolanën e plotë prej dhjetë vëllimesh të revistës “Zani i Naltë”.



"NËSE DËSHIRON
TË PAFAJËSOSH
NJË TË AKUZUAR,
FORMO PËR TË
NJË GJYKATË DHE
NËSE DËSHIRON
TË FSHEHËSH
NJË TË VËRTETË,
FORMO PËR TË
NJË KOMISION".

Xhelal Amir

(1952-2012)

“ORA E XHUMASË”
EMISIONI “ORA E XHUMASË”
RADIO JEHONA – FM 107.6

E XHUMA, ORA 11.00-12.00

RITRANSMETIM:

E DIEL: 20.45-21.45

E MARTË: 14.15-15.15

E MËRKURË: 05.30-06.30

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër

 
MYFTINIA SHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org